




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e dytë e K.K-së, e cila do të mbahet më 28.02.2022 (e hënë) duke filluar në ora 10:00h.


R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;
2. Propozim plani i punës së Kuvendit;
3. Raporti Vjetor Financiar;
4. Aktivitete reth luftimit të pandemisë;
5. Raport nga D.SH.P.M.SH. për aktivitetet e ndërmarura gjatë periudhës së reshjeve të Borës;
6. Formimi i komisionit për vlersimin e dhënjës së tokës Komunale në shfrytëzim;
7. Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave...;
8. Formimi i komisionit për emrimin e rrugëve;
9. Prurja e vendimit për Plotsim-Ndryshim të Planit Zhvillimor Komunal.
10. Prurja e Vendimit për kompletimin e Komitetit të Komuniteteve.
11. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 21.02.2022
Në: Novobërdë

zonj. Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 26.01.2022, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj.Mirjana Simijonovic, zv.Kryesuesi i Kuvendit zt.Ramush Mehmeti, Nënkryetari i Komunës për Komunitet zt.Bajrush Ymeri, Nënkryetari i Komunës zt.Svetislav Ivanovic, antarët e Kuvendit: Stefan Kovacevic, Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Violeta Milosevic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Vlora Vllasaliu, Abdyl Gashi, Ivica Cenic, Drejtori i Financave zt.Milos Denic, përfaqësuesit e OSBE-së, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit e cila pasi pershendeti të gjithë të pranishmi tha: pas kërkesës për dorëheqje të zt.Xhevat Mehmetit është kthyer vendimi i KQZ-së për znj.Pranvera Kastrati Gashi që të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal, andaj e ftoj që ta jap betimin.

Unë, Pranvera Kastrati Gashi “betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Novobërdës , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Kryesuesja e uroi anëtarin e re dhe i deshiroji punë të suksesshme. Më pastaj kryesuesja konstatoi korumin prezent janë 14 antarë të Kuvendit nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Anulimi i vendimit të aprovuar në mbledhjen e kaluar për formimin e KPF-së;
3. Formimi i KPF-së në bazë të Ligjeve në fuqi (duke respektuar barazin gjinore);
4. Formimi i Komitetit për Komunitete në bazë të Ligjeve në fuqi (duke respektuar barazia gjinore)
5. Raporti financiar për tremujorin e katërt financiar Tetor – Dhjetor 2021;
6. Propozim orari për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të KK për vitin 2022;
7. Të ndryshme.

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i ditës nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali me 13 vota për dhe 1 apstenim nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Anulimi i vendimit të aprovuar në mbledhjen e kaluar për formimin e KPF-së;

Kryesuesja tha: e dini që në mbledhjen e kaluar e kemi aprovuar vendimin për formimin e KPF por nuk ju kemi mbajtur barazis gjinore andaj na është kthyer vendimi nga MAPL-ja për mosrespektim të barazis gjinore, pra duhet fillimisht ta anulojm atë vendim, kush është për anulimin e këtij vendimi?.

Aprovohet njëzëri nga antarët prezent të Kuvendit që të anulohet vendimi për formimin e KPF-së.

Pika e tretë: Formimi i KPF-së në bazë të Ligjeve në fuqi (duke respektuar barazin gjinore);

Kryesuesja tha: pasi që i kemi emrat e antarëve të KPF-së dhe Komitetit kerkojm që të bëhen vetem disa ndryshime, kerkoj që znj.Viloeta Milosevic të kaloj nga KPF në Komitetin për Komunitete dhe zt.Negovan Jovanovic të kaloj nga Komiteti për Komunitete në KPF-ë apo nese keni ndonjë propozim tjetër urdhëroni. Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: edhe ne nga grupi i LDK-së kemi një propozim/ndryshim, në KPF-ë duhet të jetë Pranvera Gashi ndërsa në komitetin për komunitete duhet të kaloj Vlora Vllasaliu.

Pasi nuk pati diskutime tjera aprovohen njëzëri këto propozime dhe mirret ky:

VENDIM

ZGJEDHET Komiteti për Politikë dhe Financa në Komunën e Novobërdës me këtë përbërje:

1. Mirjana Simijonovic - LS
2. Negovan Jovanovic - LS
3. Dragana Dimic - LS
4. Pranvera Kastrati Gashi - LDK
5. Abdyl Gashi - VV

Pika e katërt: Formimi i Komitetit për Komunitete në bazë të Ligjeve në fuqi (duke respektuar barazia gjinore);

Kryesuesja tha: e dini se kemi mbajtur debatet publike me qytetarë ku kan marrë pjesë një numer i konsiderueshëm i qytetarëve të Komunës sonë, gjithashtu sipas ligjit propozimet tona i kemi dhënë nga Kuvendi, pra i kemi zgjedhur katër antarë të Kuvendit që të jenë në Komitet për komunitete. Ne debat u dakorduar që qytetarët të dhëjnë nga një propozim nga shoqëria civile prej të tri komuniteteve që jetojnë, në debat janë shpernda edhe format për aplikim dhe deri me 25 janar kanë pasur kohë që ti kthejnë ata formularë, nuk i diem arsyet por deri në atë datë dhe deri më sot ende nuk kan ardhur të gjithë formularët, andaj e kam shikuar edhe mundësin ligjore dhe kemi vendosur që tju dhëjmë edhe një afatë kohor disa ditësh të gjitha komuniteteve që ti dorzojnë këta formualrë. E kam menduar që në fillim të shkurtit ta mbajmë një mbledhje të jashzakonshme ose nese ju mendoni se nuk është shkelje e ligjit do ta mbajm në fund të shkurtit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Selatin Nuhiiu pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket këtij debati unë permes rrjeteve sociale jam njoftuar se është mbajtur ky debat, unë në atë foto e kam parë vetem Kryesuesen dhe zv.Kryesuesen dhe asnjë qytetarë dhe unë si antarë i zgjedhur i komitetit për komunitete nuk kam qenë i ftuar fare në takim, ndoshta kishte me qenë e udhës që të ftohen më shumë qytetarë që të bëhet një zgjedhje më e duhur sa i perket edhe kryesuese së komitetit, besoj se në takimin e ardhshëm do të jem i ftuar si antarë i zgjedhur për komitete, ju faleminderit.

Ramush Mehmeti tha: sa i perket asaj që Selatini e cekti them se ka pasur njerëz por ka pasur pak prej të tri komuniteteve, unë jom dakord që kjo pikë të shtyhet pasi që pa qenë në harmoni me ligjin nuk mundet me qenë përfaqësues i qytetarëve nese një person nuk ka mbledhur sa paku 100 nënshkrime, për debat nuk janë duhur ftesat pasi që debati ka qenë i hapur për të gjithë.

Kryesuesja tha: po i pergjigjem Selatinit, kur i kemi bërë ftesen për debat i kemi shpernda në të gjitha vendbanimet ashtu siç kerkohet në bazë të Ligjit 14 ditë para mbajtjes së debatit ka qenë njoftimi, ata që kanë qenë të interesuar kanë marrë pjesë, vetem se në njoftim i kemi lutur qytetarët që ti respektojnë masat e IKSHPK-së që të mbajnë distancë dhe që në sallë mundë ti pranojmë vetëm 30 persona.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: është fjalimi im i parë që po mbajë për këtë mandatë dhe po dal pak prej temës por po e bëjë që mos të përseritet më që nuk bënë mikrofonin ose ka prishje teknike por ta marmi më seriozisht pak punën e Kuvendit, pasi që jemi duke ardhur në organin më të lartë të Komunës sonë. Sa i përket komitetit për komunitete unë kam qenë pjesë edhe në mandatin e kaluar por e gjithë puna varet prej Kryesueses/it që do të zgjidhet, andaj ju lus që të jetë një formim më i mirë dhe një kuader që ti perfaqësojë të gjitha komunitetet.

Kryesuesja tha: formimi i komitetit për komunitete të shtyhet për mbledhjen e ardhshme ose nese do të vendosim të mbajmë një mbledhje të jashtëzakonshme ju do të njoftoheni me ftesa në bazë të ligjit, kush është që të shtyhet kjo pikë?

Me 14 vota për nga antarët prezent të Kuvendit, shtyhet kjo pikë për një afatë të pacaktuar.

Pika e pestë: Raporti financiar për tremujorin e katërt financiar Tetor – Dhjetor 2021;

Kryesuesja tha: para se të fillojmë të diskutojmë rreth këtij raporti fillimishtë e uroj Drejtorin z.Milos Denic dhe i deshiroj punë të suksesshme dhe profesionale dhe shpresoj se do ta vazhdojmë bashkpunimin me Drejtorin e Financave ashtu siç e kemi pasur me Drejtorin e kaluar, gjithashtu ju falenderohem që ju keni pergjigjur kërkesës tonë, edhe pse kërkesën e kemi dorzuar në momentin e fundit, besoj se antarët e Kuvendit e kanë marrë me kohë materialin.

Kryesuesja ja kaloi fjalën Drejtorit të Financave që të prezantojë këtë pikë.

Milos Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: e falenderoj Kryesuesen për urimin ashtu siç e cekim koha që të pregaditet ky raport ka qenë në afat të shkurte, por jam munduar që sa më mirë dhe sa më shpejt ta punoj dhe besoj që ju keni pasur kohë ta shqyrtoni. Para jush e keni raportin financiar të tremujorit të katërt për vitin 2021, në tabelë i keni paraqitur të hyrat tatimore dhe jo tatimore, të hyrat totale për këtë periudhë kohore janë 126,233.80€ duke u përfshirë të hyrat nga tatimi në pronë, nga regjistrimi i automjeteve, vertetima taksa komunale etj., në këtë periudhë kemi pasur edhe dy kode të hyrave, një ka qenë participimi i qytetarëve në subvencione dhe tjetra kanë qenë donacion nga këshilli evropian. Më pastaj i kemi shpenzimet në paga dhe medita 526,563.00€, mallra dhe shërbime 519,264.45€, shpenzime Komunale 26,068.90€, subvencione 46,110.00€, Investime kapitale 247,570.02€. Më pastaj i keni shpenzimet e ndara për secilin Drejtor veç e veç, kaq nga unë nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: e uroj Drejtorin për pozitën e re, edhe pse ka punuar edhe më herët në këtë Drejtori, e kam një pyetje të tabela e parë taksa për ndërrimin e destinacionit të tokës vlera 86,875.50€, edhe një vërejtje që kërkojë që mos të përseritet shpenzimet në shumë Drejtori janë cek vetëm shpenzime kontraktuese tjera dhe nuk po dihen se çfarë shpenzime janë. Kuvendi duhet ta dijë për çdo cenë se ku është shpenzuar, nuk ka shpenzim që nuk duhet ditur Kuvendi si dhe shumë mjete janë marrë nga përmbaruesi privat, të kemi kujdes që obligimet të paguhën me kohë.

Milos Denic tha: fillimisht po pergjigjem në atë pjesën e parë prej 86,875.50€ në kodin 50012 këtu bëhet fjalë për grumbullimin e mjeteve nga destinimi i tokës, kontratat e shitblerjes dhe punët e ngjajshme, pasi që nuk kemi kode ekonomike të veçanta janë grumbulluar këtu mjetet.

Selatin Nuhiiu tha: të mjetet e shpenzuara është tabela në Drejtorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të subvencionet 37,700.00€ janë ndarë mjete bujqësore për fermer, andaj kishte me qenë mirë që të jetë edhe Drejtori i Bujqësisë Prezent në mënyrë që të dimë se a ka pasur komision që ka bërë vlersimin, në bazë të informatave që unë kam dëgjuar kanë përfituar vetëm antarët e një subjekti politik konkretisht të LDK-së, nese ska qenë i LDK-së nuk ka marrë paisje bujqësore. Kemi fakte se në fshatin Llabjan janë shpernda paisje bujqësore të Xhamia ndërsa pak më poshtë të udhëkryqi janë shit ato paisje, andaj kërkoj

nga ju që të Kordinoheni me Drejtorin e Bujqësisë dhe për mbledhjen e radhes ta kemi listen se kush ka perfituar paisje bujqësore.

Ramush Mehmeti tha: çdo antarë i Kuvendit ka të drejt me inicua procedura, me bë kërkesa, po pajtohem me Selatinin që në seancen e radhes te kerkojm listen, mirëpo të paragjykojm pa e pasur listen se ky është LDK, ky është PDK nuk bënë.

Kryesuesja tha: ti drejtohem edhe njëher zt.Mehmetit dhe tja kujtoj se ky raport financiar është i temujorit të fundit të vitit të kaluar, tani është viti 2022 është fillim i ri, e dini se pas zgjedhjeve është ndrruar edhe Kryetari i Komunës, janë ndrruar edhe disa antarë të Kuvendit edhe pse shumica janë nga përbërja e kaluar dhe kanë përvoj në punë, besoj se në periudhen e ardhshme do të kemi bashkpunim të mirë dhe të afërt me të gjithë si me Kryetarin ashtu edhe me Drejtorat.

Selatin Nuhiu tha: unë nuk pajtohem me Ramush Mehmetin pasi që ai 4 vite ka paragjykuar ashtu siç po mendon se po paragjykoj unë tani.

Mirjana Simijonovic tha: edhe unë jam e brengosur ashtu siç jeni edhe ju, këtë qështje do ta ngrisim do të bëjmë kërkesë, por mendoj se kjo është e tepert që të thuhet se merr subvencion ose jo nese je i kësaj parti apo jo, ne do ta kerkojm listen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe në atë list do të shohim se ai person a është bujk apo jo që ka përfituar subvencion.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 12 vota për, 2 kunder (Abdyl Gashi, Pranvera Kastrati Gashi) nga antarët prezent të Kuvendit aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET raporti financiar i Komunës së Novobërdës për tremujorin e katërt financiar Tetor - Dhjetor të vitit 2021.

Pika e gjashtë: Propozim orari për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të KK për vitin 2022;

Kryesuesja tha: e keni marrë orarin për mbajtje të mbledhjeve të Kuvendit për këtë vit të pregaditur nga administrata Komunale. I kemi shikuar datat që mbledhjet mos të mbahen në ëikend, mos të mbahen ditëve të premte, si dhe festave zyrtare dhe fetare. Kryesuesja i lexoj të gjitha datat dhe i pyeti antarët e Kuvendit se a kan ndonjë datë që duhet ta ndryshojnë?.

Pasi nuk pati asnje propozim kjo pike u aprovua njëzëri nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e gjashtë: të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: në mënyrë që Kuvendi të funksionoj ashtu siç duhet propozoj që Kuvendi të formoj një komision prej tre antarëve që të punoj në planë të punës së Kuvendit dhe hartimin e rregullores së punës së Kuvendit. Qështja tjetër është se një ndryshim i vogel po shihet se në këtë qeverisje lokale të pakten Drejtorat dhe Nënkryetarët janë prezent shpresoj që në seancen e radhes edhe kryetari i Komunës të jetë prezent. Një gjë tjetër shqetësuese është se Kuvendi në mandatin e kaluar asnjëherë nuk aprovuar Rregulloren për taksa ngarkesa dhe gjoba Komunale, është ndarë kodi për subvencione në bujqësi ndërsa Kuvendi Komunal nuk ka rregullore për ndarje të subvencioneve, po ashtu kemi rregulloren për ndarje të subvencioneve në shendetësi. Ju e dini se Kuvendi në vitin 2019 ka marrë vendim që Kryetari mos të shpenzoj asnjë cent subvencion pa leje të Kuvendit, pra kërkoj nga kjo qeverisje që këto rregullore ti bin në Kuvend për ti aprovuar, ju faleminderit.

Stojan Sanojevic pasi pershendeti të pranishmit tha: pasi që jam antar i ri fillestar në Kuvend e kam para vetit Ligjin për Vetqeverisje Lokale, neni 39 të drejtat dhe detyrat e antarëve të kuvendit të komunës, neni 39.1 thot se të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë plotësishtë në punimet e Kuvendit. Kuvendi i Komunes siguron që këto të drejta dhe mundësi të parashikohen në statutin dhe në rregulloren e tij të punës, andaj kërkoj nga Kryesuesja që të na dergoj statutin dhe rregulloren e punës së Kuvendit. e kam edhe një paraqitje, nuk jam kunder që të punësohen njerëzit që të mundë të sigurojn edhe ekzistencen njerzore mirëpo kemi pasur fatkeqësishtë veprime kur 3

ditë para zgjedhjeve disa puntorë kanë marrë vendimin për ndërprerje të punës, nuk kam kunder askujt asgjë që janë punësuar apo janë punësuar puntorët e rinjë, por kam kunder atyre që u është ndërprerë mardhënja e punës dhe Komuna mundë ti bartë pasojat pasi që këtyre punëtorëve që ju është ndërprerë mardhënja e punës do të ankohen në gjykatë dhe nese gjykata i kthen do të kemi pasoja financiare. Me ligj ceket se çdo antarë i Kuvendit pamvarishtë se a është antarë i ndonjë komisioni apo jo mundë të marrë pjesë në punën e atij komisioni, vetem se ska të drejt vote. Tani jemi në periudhën e dimrit dhe disa njerëz më kanë njoftuar se te pjesa e rrugës Prekovc – Gjilan nuk po mundë të kalojnë, gjithashtu disa mjete kanë pasur edhe aksident. Po pajtohem me Selatinin se nuk është me rëndësi se kush merr subvencione shqiptarë apo serb por me rëndësi është që të përfitojnë bujqët, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: sa i perket statutit dhe Rregullores së punës së Kuvendit janë të hapura për të gjithë dhe keni pasur mundësi ti merrni edhe më herët kur nuk keni qenë pjesë e Kuvendit, po më vjen mirë që i keni lexuar këto ligje pasi që edhe ne i kemi lexuar dhe duhet të punojmë në kuader të ligjit. Për qështjet tjera të cilat i ngritet për Drejtori të ndryshme, Komuna i ka Drejtorat dhe kemi mundësi që ti kerkojm ato raporte. Gjithashtu t'ju sqaroj se Kryetari nuk është i obliguar që të merr pjesë në çdo mbledhje edhe pse sot ka pasur që të merr pjesë por i ka dal një punë zyrtare. Ju infomoj se Kryetari i Komunës e ka për obligim që të raportoj dy herë në vit.

Stojan Stanojević tha: e kam lexuar ligjin dhe e kam parë se Kryetari i Komunës është obligativ që të merr pjesë në çdo mbledhje.

Kryesuesja tha: po më vjen mirë që po e shprehni dëshirën që Kryetari i Komunës të merr pjesë në çdo mbledhje dhe organet tjera të raportojnë.

Milica Jovanovic pasi pershendeti të pranishmit tha: pasi që edhe në vitet e kaluar për tju lehtësuar puna antarëve të Kuvendit kemi marrë mbushje propozoj që përseri të mirret ky vendim për mbushje telefonike. Gjithashtu i uroj Drejtorët prezent për pozitat e tyre dhe i faslenderohem Drejtorit të shërbimeve publike që është prezent i cili qysh në ditët e para që ka filluar bora ka dal me ekipen e vet dhe kan pastruar rrugët lokale, vetem një sygjërim të vogël nese bënë, kur ta pastroni këtë pjesën e rrugës në fshatin Bostan të pastrohet edhe ajo pjesë prej rrugës kryesore deri të kisha pasi që është edhe koha e festave fetare, ju faleminderit.

Kryesuesja tha: e kemi pasur edhe më herët këtë propozim çdo fillim vit kemi aprovuar vendimin për mbushje telefonike nga 10€ për anëtarët e Kuvendit ndërsa nga 20€ për Kryesuesen dhe zv.Kryesuesin.

Ramush Mehmeti tha: unë mendoj se në këtë propozim duhet të shtohet Kryesuesi/ja i komitetit për komunitete pa marrë parasysh se kush do të zgjidhet.

Selatin Nuhiu tha: unë propozoj që tju ipen të gjithë antarëve të komitetit për komunitete, e jo vetem kryesuesit.

Pranvera Kastrati Gashi tha: kerkoj që të jenë të barabartë me mbushje si Kryesusi si zv.Kryesusi si antarët e Kuvendit.

Kryesuesja tha: e dini se Kuvendi e ka të caktuar buxhetin vjetor për të gjitha shpenzimet e në ato shpenzime hyjn edhe mbushjet telefonike.

Selatin Nuhiu tha: e kam edhe një propozim tjetër, tju ndahen së paku nga 5€ komitetit për komunitete.

Kryesuesja tha: këtë qështje fillimisht po e lëjm të hapur ashtu si ti kemi mundësit buxhetore do tju ndajm pastaj.

Dobrivoje Djordjević pasi pershendeti të pranishmit tha: pse mos të bëjmë rrjetin dhe të hym në një rrjet ku kushton 2€ dhe të jemi të gjithë në atë rrjet.

Kryesuesja tha: do ti shikojm ato mundësi dhe do të shikojm se sa është numri maksimal që mundë të kyçen në atë rrjet.

Kryesuesja e hudhi në votim propozimin e Milica Jovanovic që Kryesuesja dhe zv.Kryesuesi ti marrin nga 20€ në muaj ndërsa antarët e Kuvendit nga 10€.

Nga 13 antarë prezent të Kuvendit aprovohet njëzri ky propozim për mbushje telefonike dhe bihet ky:

VENDIM

Është marrë vendimi që të aprovohen mbushjet telefonike.

Kryesuesja tha: para se ta përfundojm mbledhjen e kam një kërkes nga një banor i fshatit Vllasali që ta merr fjalën.

Hysni Vllasaliu banor i fshatit Vllasali pasi pershendeti të pranishmit tha: unë i kam katër kërkesa, rruga, ndriqimi, ujësjellësi, kanalizimi. Në fshatin Vllasali janë të gjitha me ndriqim, me rrugë, me ujësjellës me kanalizim e vetem mahallen tonë e kan nda që është 400m distanc, jetojna 6 familje por skemi asgjë. E kam fermen e deleve, ujësjellësi është por ujë kurr skem. Asnjë cen ndihm prej Komunës nuk kam marrë edhe pse tatimin e paguj në këtë Komunë.

Kryesuesja tha: për propozimin që e bëjë Ramushi propozoj pauz 10min për formimin e komisionit.

Pas pauzes 10 min mbledhja vazhdoi.

Kryesuesja tha: ashtu siç e tham edhe para pauzes, Kryesuesja dhe zv.kryesuesi automatikisht janë pjesë e komisionit, por kerkoj edhe tri propozime nga antarët e Kuvendit.

Negovan Jovanovic propozoi Violeta Milosevic.

Ivica Cenic propozoi Stojan Stanojevic.

Ramush Mehmeti propozoi Selatin Nuhii.

Nga 13 antarë prezent të Kuvendit aprovohet njëzëri kjo pikë dhe bihet ky:

VENDIM

FORMOHET komisioni për hartimin e Rregullores së punës së Kuvendit.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:55.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse

Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPSTINE

DATE/A:	08.02.2022
PËR/ZA/TO:	Antarët e Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Mirjana Simijonovic – Kryesuese e Kuvendit Predsedavajuca Skupstine
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i punës së Kuvendit

Në bazë të nenit 12 paragrafit 2 pika d), dhe nenit 40, paragrafi 1 dhe 2, pika d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale dhe në bazë të nenit 34 pika 5 të statutit të Komunës së Novobërdës nr.01-992 propozon këtë:

Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Novobërdës për vitin 2022
Shkurt

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Raporti Vjetor Financar	Drejtorja e Fin.	KPF/KK
Aktivitete rreth luftimit të pandemisë	Komisioni i Pandemisë	KPF/KK
Aktivitete rreth tejkalimit të situatave të jashzakonshme (bor,shi) shqyrtimi i mundësis për ndihm familjeve në nevoj	D.SH.P.M.SH	KPF/KK
Formimi i Komisionit per dhenje te tokes Komunale ne shfrytezim	Kryetari i Komunes	KPF/KK
Formimi i Komisionit per emrimin e rrugeve	Kryetari i Komunes	KPF/KK

Mars

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Aktivitete rreth luftimit të pandemisë	Komisioni i Pandemisë	KPF/KK
Shqyrtimi i mundësisë për ndihmë bujqëve për mbjellje pranverore	Drejtoria e Bujqësisë	KPF/KK
Raportim nga Drejtoria e Bujqësisë për listen e perfituesve të paisjeve bujqësore	Drejtoria e Bujqësisë	KPF/KK
Drejtoria e Urbanizmit të përgadise listën e pronave Komunale të kategorizuara në toka bujqësore, mal dhe ndërtimore	Drejtoria e Urbanizmit	KPF/KK

Prill

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Aktivitete rreth luftimit të pandemisë	Komisioni i Pandemisë	KPF/KK
Raporti tremujor financiar janar-mars 2022	Drejtoria e Financave	KPF/KK
Plani për Mirëmbajtjen e hapësirave të hapura Publike 2022/26	D.SH.P.M.SH	KPF/KK
Plani për investimin e hapësirave publike të hapura 2022/26	D.SH.P.M.SH	KPF/KK

Maj

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Aktivitete rreth luftimit të pandemisë	Komisioni i Pandemisë	KPF/KK
Informata e parë rreth qarkores buxhetore për vitin aktual	Drejtoria e Financave	KPF/KK
Panifikimi dhe mbajtja e takimeve të Kuvendit me qytetarët e Komunes rreth propozimit buxhetit 2022/25	Drejtoria e Financave	KPF/KK
Draft Rregullore për mbeturina të ngurta	D.SH.P.M.SH	KPF/KK
Plani Operativ për Emergjencë	D.SH.P.M.SH	KPF/KK

Aprovimi i planit aksional për dialogun Ndëretnik	ZKKK	KPF/KK
---	------	--------

Qershor

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Raportim nga Drejtoria e Bujqësisë rreth planit të korrje-shirjeve	Drejtoria e Bujqësisë	KPF/KK
Aktivitete rreth luftimit të pandemisë	Komisioni i Pandemisë	KPF/KK
Aprovimi i KAB-it për vitin aktual	Drejtori i Financave	KPF/KK
Rishikimi i buxhetit për vitin 2022	Drejtori i Financave	KPF/KK

Korrik

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Aktivitete rreth luftimit të pandemisë	Komisioni i Pandemisë	KPF/KK
Raportim nga Drejtoria e Arsimit për vitin perfundimin e viti shkollor 2021/22	Drejtoria e Arsimit	KPF/KK
Raporti gjashtëmujor i Kryetari të Komunës	Kryetari i Komunës	KPF/KK
Raporti financiar i tremujoreit të dytë Prill-Qershor 2022	Drejtori i Financave	KPF/KK
Aprovimi i rregullores për mbeturina të ngurta	D.SH.P.M.SH	KPF/KK
Aprovimi i raportit të punës për gjashtëmujorin e parë të ZKKK	ZKKK	KPF/KK

Shtator 1

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Aktivitete rreth luftimit të pandemisë	Komisioni i Pandemisë	KPF/KK
Shqyrtimi i propozim buxhetit për vitin 2022/23	Drejtoria e Financave	KPF/KK
Raporti nga Drejtoria e Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2021/22	Drejtoria e Arsimit	KPF/KK
Raporti nga Drejtoria e Bujqësisë për perfundimin e korrje shtrirje	Drejtoria e Bujqësisë	KPF/KK
Aprovimi i planit të veprimtimit për kthim dhe të zhvendosur 2022-2024	ZKKK	KPF/KK

Shtator 2

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Aprovimi i buxhetit për vitin 2022/24	Drejtoria e financave	KPF/KK
Aktivitete rreth luftimit të pandemisë	Komisioni i Pandemisë	KPF/KK

Tetor

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Aktivitete rreth luftimi të pandemisë	Komisioni i Pandemisë	KPF/KK
Raporti financiar i tremujorit të tretë për vitin 2022	Drejtoria e Financave	KPF/KK
Raport nga D.SH.P për sezonin e dimrit	D.SH.P.M.SH	KPF/KK

Nëntor

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Aktivitete rreth luftimi të pandemisë	Komisioni i Pandemisë	KPF/KK

Dhjetor

Aktiviteti	Propozuesi	Shqyrton
Aprovimi i Raportit vjetor të punës i ZKKK	ZKKK	KPF/KK
Raporti Vjetor i punës së Kuvendit	Kryesuesja e Kuvendit	KPF/KK



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTEJE DHE SHPETIM
DIREKTORIJAT ZA JAVNE USLUGE ZASTITU I SPASAVNJE

DATË/A:	14.02.2022
PËR/ZA/TO:	Komitetin për politik dhe financa
NGA/OD/FROM:	z.Gafurr Vllasaliu , Drejtor për shërbime publike mbrojtje dhe shpëtim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raportë

Me anë të këtij raportit deshta të ju informoj në lidhje me pastrimin e rrugëve lokale dhe regjionale nga bora në Komunën e Novobërdës.

Sa i përket rrugëve regjionale janë të pastruara nga Kompania ELBAU nga Gjilani , që është e kontraktuar nga Ministria e Infrastrukturës , kemi kontaktuar me Kompanin përmes telefonit , për ti mirembajtur rrugës sa më mirë.

Sa i përket rrugëve Lokale , ne si drejtori e shërbimeve publike kemi dalur në teren çdo ditë prej datës 21.01.2022 deri më sot , ku jem duke raportuar para jush.

Ne si Drejtori e Shërbimeve Publike kemi një traktor për pastrimin e borës ku kemi punuar me kapacitet të plotë me dy ndërrime për ti mbajtur rrugët të pastruar, gjithashtu Komuna e ka angazhuar edhe një Kompani tjetër për 200-kilometer, për tu na dalur në ndimë,ni disa fshatera-lagje, për të qenë të gjitha rrugët e pastruara,përveq një rrugë te familja e Izmirit që është bllokuar nga debora në pamundesë për hapjen e rrugës,me që rruga është e bllokuar ne si drejtori kemi qen ne kontakt gjdo dit.

por të gjithë rrugët tjera kanë qënë të hapura nuk kemi pasur probleme të theksuar.

Andaj dua ti falenderoj të gjithë punëtorët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike , njësinë e zjarrëfiksëve dhe Drejtorin e Administratës , njëkohësisht edhe Kryetarin e Komunës për mbështetje.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMUNA E NOVOBËRDËS
OPŠTINA NOVO BRDO

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRI I TREGUT DHE TËRËSI
DHE TËRËSI
05/20
2021
NOVO BRDO

REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRI I TREGUT DHE TËRËSI
DHE TËRËSI
05/20
2021
NOVO BRDO

Neni 12

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: AHMET ISMAILI, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Nga: SAŠA MILOŠEVIĆ, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)

ZORAN CVETKOVIĆ, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tone, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përshirë shënimeve për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënime financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021 dhe është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

